



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 36
Prishtinë, 24 mars 2009, ora 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj , Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Munguan: Gjylnaze Sylja dhe Slobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI: Shefki Kastrati.

Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Nga KDI: Rrezarta Ahmeti.

Nga OSBE: Petrit Hysa.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtjet.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;

Sadik Idriz – Tha se Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës është miratuar në seancën e kaluar . Këtë mbledhje nuk do ta shqyrtojmë por do të formojmë grupin punues. Ju kam sjell edhe një kopje të Ligjit për të huajt të Malit të Zi i cili ishte shumë konciz dhe mendoj se mund ta kemi si mostër gjatë amendamentimit të ligjit. Çdo ligj ka specifikat e veta dhe shtetet e ndryshme e kanë të rregulluar në formë të ndryshme, por ne mund të marrim informacione nga ligjet e shteteve tjera dhe pastaj të bëjmë amendamentimin e ligjit tonë.

Mimoza Ahmetaj – Propozoj që pasi dokumentet i kemi marrë sot , për ligjin të debatohet javën e ardhshme.

Sadik Idriz - Tha se këtë takim nuk do ta shqyrtojmë ligjin vetëm do ta formojmë grupin punues.

Teuta Hadri – Propozoj që Ligji i Malit të Zi të përkthehet nga administrata në gjuhën shqipe.

Sadik Idriz - Njoftoj anëtarët se është e pamundur të përkthehen ligjet e shteteve tjera nga administrata sepse nuk ka staf të mjaftueshëm.

Bujar Bukoshi – Tha se edhe unë mendoj se është e pamundur të përkthehen ligjet e vendeve tjera , por ky ligj është si ndihmës nuk është obligative .

Pas diskutimeve u formua grupi punues për shqyrtimin e P/Ligjit në përbërje :

Flora Brovina , Bujar Bukoshi dhe Rita Hajzeraj .

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – Tha se në këtë pikë desha të ju njoftoj që ministri i shëndetësisë ka kërkuar që raporti i monitorimit, i cili është radhitur për shqyrtim në seancë e radhës të shtyhet për një seancë tjetër . A pajtoheni që kjo pik të shtyhet me pëlqimin e komisionit ?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që raporti i monitorimit të shtyhet për shqyrtim në një seancë tjetër.

Gjithashtu Komisioni u pajtua që ta ftojë për raportim , ministrin e shëndetësisë, pas dy javësh.

Mbledhja përfundoi në orën 11: 45.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Sadik Idriz